



Pranuar / Dostaveur Punlyene / Prodato Received / Delivered	15.06.2022	2	viti god. year
Organ / Shlyssa Organ / Jednitsa Org / Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHTICK	3492/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.157/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1361/2020 të datës 30.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.157/2020 të datës 09.06.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë fshati [redacted] kundër Vendimit me Nr. 01-112-14473 i datës 07.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "transferim i përhershëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.06.2022, mori këtë

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.157/2020 e datës 09.06.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted].
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 01-112-14473 i datës 07.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit dhe Vendimi me numër 01Nr. 112/02-13283 i datës 11.03.2020 i Kryetarit të Komunës së Drenasit.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Drenasit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin [redacted] në pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian" sipas Akt Emërimit të datës 04.06.2012.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi [REDACTED] punësuar në Komunën e Drenasit, përmes postës më datë 05.06.2020 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 09.06.2020 dhe është protokolluar me numër 1115/2020, kundër Vendimit me Nr. 01-112-14473 të datës 07.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Drenasit. Ndërsa Këshilli më datë 24.06.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Drenasit bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje më datë 17.07.2020 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative. Ankuesi ka ndjekur procedurat gjyqësore duke hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 30.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1361/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të datës 17.07.2020 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për aneksën A.nr.157/2020 të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.06.2020 me numër protokoll 1115/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01-112-14473 të datës 07.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit; Vendimin me numër 01Nr. 112-8264 i datës 13.02.2019; Vendimin me numër 01Nr. 112/02-13283 i datës 11.03.2020; Ankesën e datës 10/04/2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit; Njoftim për pjesëmarrje e Udhëheqësit të Zyrës Komunale për Integritet Evropian në takimet e bordit të drejtorëve datë 22.07.2013; Shkresë njoftuese për organizimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për Integritet Evropian në nivel lokal e datës 07.02.2019 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Njoftim për Komunën e Drenasit i datës 06.08.2014 nga Ministria e Administratës Publike; Zarin e postës i datës 05.06.2020; Akt Emërimit e datës 04.06.2012 të ankuesit; Flete dorëzimi i datës 07.05.2020; Procesverbal i datës 07.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Organogrami i Komunës së Drenasit; Njoftimin e datës 25.02.2020 për ankuesin; Shkresën e datës 26.02.2020 të ankuesit; Kërkesën për plotësimin e pozitës Shef i Sektorit për Shërbime Publike e datës 04.03.2020 nga Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave i Komunës së Drenasit dhe Përgjigjen në ankesë e datës 24.06.2020; Njoftimin e datës 17.07.2020

për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr.1361/2020 të datës 30.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi [redacted] është i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian" sipas Akt Emërimit të datës 04.06.2012 në Komunën e Drenasit. Kryetari i Komunës së Drenasit ka nxjerr Vendim me numër 01Nr. 112-8264 të datës 13.02.2019 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit në pozitën "Shef i Sektorit për Shërbime Publike", ndërsa Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Drenasit më datë 25.02.2020 ka njoftuar ankuesin se me Planin e Personelit për vitin 2020 pozitën e mëparshme në Zyrën e Kryetarit e ka planifikuar "Zyrtar për Integritet Evropian" andaj jemi të obliguar të ju sistemojmë në një pozitë ekuivalente.

Më datë 04.03.2020 Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencia në Komunën e Drenasit ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës në bazë të të cilës ka kërkuar plotësimin e pozitës "Shef i Sektorit për Shërbime Publike". Kryetari i Komunës së Drenasit ka aprovuar kërkesën e lartcekur dhe më datë 11.03.2020 ka nxjerr Vendim me numër 01Nr. 112/02-13283 me të cilin ankuesin e ka transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita "Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian" në pozitën "Shef i Sektorit për Shërbime Publike" me arsyetimin se pozita Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian me Plan të Personelit është shëndërruar në pozitën Zyrtar për Integritet Evropian dhe pozita ku transferohet është e domosdoshme.

Ankuesi kundër vendimit të Kryetarit të Komunës së Drenasit për transferimin e tij, më datë 10.04.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit më datë 07.05.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-112-14473 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-112-14473 të datës 07.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit dhe Vendimit me numër 01Nr. 112/02-13283 të datës 11.03.2020 të Kryetarit të Komunës së Drenasit, pretendon që transferimi është bërë pa pëlqimin tim që është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse kam akt emërim të përhershëm dhe pozita nuk mund të shuhet me plan të personelit por duhet të bëhet me bazë ligjore prandaj edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se transferimi është bërë pa pëlqimin tim që është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse kam akt emërim të përhershëm dhe pozita nuk mund të shuhet me plan të personelit por duhet të bëhet me bazë ligjore, konstaton që Zyra Komunale për Integritet Evropian është e paraparë me Rregullore Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian respektivisht neni 6 paragrafi 1 i kësaj rregulloreje

parasheh që Zyra udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës i cili është përgjegjës për funksionimin e saj dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryetarit të Komunës, ndërsa paragrafi 4 i nenit 6 të kësaj rregulloreje në mënyrë taksative përcakton që numri i stafit të Zyrës do të përcaktohet nga Kryetari i Komunës, në varësi të nevojave të secilës komunë dhe do të përcaktohet në konsultim me strukturat përgjegjëse të Ministrisë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale, ndërsa buxheti i saj do të jetë pjesë e buxhetit të komunës, mbi bazë të kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që rregullorja në fjalë parasheh Zyrën Komunale për Integritim Evropian që e udhëheq Udhëheqësi i saj, rrjedhimisht ndryshimi i kësaj zyre nëse është e domosdoshme duhet të bëhet në koordinim me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe Ministrinë e Integritimit Evropian, ndërsa në rastin konkret Komuna e Drenasit ka bërë shuarjen e pozitës “Udhëheqës i Zyrës për Integritim Evropian” duke e paraparë vetëm pozitën Zyrtar për Integritim Evropian pa koordinim me institucionet përkatëse të paraparë me këtë rregullore dhe këtë e ka bërë vetëm me planin e personelit, kështu që Kolegjin për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, çdo ndryshim i kësaj zyre pa koordinim paraprak me institucionet gjegjëse është në kundërshtim me këtë rregullore, po ashtu Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal në bazë të shkresës njoftuese për organizimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për Integritim Evropian në nivel lokal të datës 07.02.2019 të dërguar për Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës ka njoftuar që duke parë rëndësinë e funksionimit të Zyrave Komunale për Integritim Evropian në procesin e përmbushjes së obligimeve që dalin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe adresimit të sfidave të evidentuara nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovës, përmes kësaj shkresë ri-përsërisim kërkesën tonë për themelimin e këtyre zyrave apo emërimin e zyrtarit të komunës për integritim evropian aty ku nuk janë të emëruar ende dhe fuqizimin e tyre në komunat ku tashmë janë vendosur në kuadër të strukturës organizative, mbi bazë të kësaj Komuna e Drenasit ka pasur të themeluar këtë zyrë pasi që ankuesi ka akt emërim që nga data 04.06.2012 dhe në asnjë formë kjo shkresë nuk nënkupton shuarjen e zyrës dhe përcaktimin e pozitës së udhëheqës në pozitën zyrtar.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me numër 01Nr. 112/02-13283 i datës 11.03.2020 i Kryetarit të Komunës së Drenasit për transferimin e ankuesit nga pozita “Udhëheqës i Zyrës për Integritim Evropian” në pozitën “Shef i Sektorit për Shërbime Publike” është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritim Evropian, Shkresën njoftuese për organizimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për Integritim Evropian në nivel lokal të datës 07.02.2019 të dërguar për Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe po ashtu në kundërshtim edhe me dispozitat e 32 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se sipas nenit 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet që: *“Nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë”*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve

dhe Ankesave i Komunës së Drenasit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01-112-14473 të datës 07.05.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Krvetari i Komunës së Drenasit në pajtim me këtë vendim është i obliguar që ankuesin [redacted] ta kthejnë në pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Integritime Evropiane" sipas Akt Emërimit të datës 04.06.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.157/2020

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

